



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 32/ Prot.
8

Tiranë, më 07.10.2022

V E N D I M

Nr. 123, datë, 07. 10. 2022

PËR PUSHIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR

Komisioni i Policisë Gjyqësore pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore materialet e procedimit disiplinor në ngarkim të oficerit të policisë gjyqësore Koçi Gega, dëgjoi pretendimet e tij dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

1. Mbi kërkesën e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe, “Për proçedimin disiplinor të oficerit të Policisë Gjyqësore të Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Koçi Gega, protokolluar në Komisionin e Policisë Gjyqësore me numër protokolli 32, datë 12.07.2022, Komisioni i Policisë Gjyqësore, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 36, pika 1 e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, ka nxjerrë Urdhërin nr.79, datë 21.07.2022 “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Koçi Gega”, për kryerjen e shkeljeve disiplinore, “Kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Proçedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”, të nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, neni 33, pika 4, gërma “ç”, e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

2. Nga përmbajtja e kërkesës së Prokurorit Andi Pogaçe dhe Relacioni shoqërues, rezulton se si bazë për kërkesën për fillimin e proçedimit disiplinor kanë shërbyer veprimet dhe mosveprimet, në shkelje të kërkesave të ligjit procedural penal, të kostatuara në hetimin e proçedimit penal nr.498, regjistruar në datën 17.05.2022, për veprat penale, “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” (në gjendje të dehur), parashikuar nga nenet 290/2 dhe 291 të Kodit Penal.

Nga aktet që u administruan gjatë seancës dëgjimore për proçedimin disiplinor, rezulton se:

2.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, në datën 17.05.2022 ka regjistruar procedimin penal Nr. 498, të vitit 2022 për veprat penale, “*Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor*” dhe “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*”, në gjendje të dehur, të parashikuar nga nenet 290/2 dhe 291 të Kodit Penal. Për hetimin e këtij procedimi penal është ngarkuar oficeri i Policisë Gjyqësore i Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Koçi Gega, i cili, ka referuar edhe materialin kallëzues në prokurori.

2.2 Nga aktet e procedimit penal rezulton se në datën 27.04.2022, në afërsi të fshatit Cakran, në segmentin rrugor Fier – Cakran, në vendin e quajtur “Fermë” automjeti i markës Wolsvagen Touran i drejtuar nga shtetasi Idajet Tafa është goditur nga nga një motor pa targa që drejtohej nga shtetasi Floren Myrtaj, i cili nuk ka qenë i paisur me leje drejtimi për mjete motorike. Nga ky aksident ka ngelur i dëmtuar drejtuesi i motorit Floren Myrtaj, i cili është transportuar për në spital.

Nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Koçi Gega, pasi janë kryer veprimet e para hetimore, në datën 29.04.2022, materialet janë referuar për vlerësim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

Nga materialet e procedimit penal rezulton se për këtë ngjarje, është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit autoteknik, kryerjen e ekspertimit mjekoligjor për kategorinë e dëmtimeve të pësura nga shtetasi Floren Myrtaj si dhe është marrë mostra e gjakut nga shtetasi Floren Myrtaj dhe është dërguar për ekspertim toksikologjik në Institutin e Mjekësisë Ligjore, për të evidentuar nivelin e alkolit në gjakun e shtetasit Floren Myrtaj, apo nëse ka qenë nën ndikimin e lëndëve narkotike.

2.3 Në vijim të hetimeve, nga ana e prokurorisë, është administruar Akti Ekspertmit Toksikologjik, 1699, datë 03.06.2022, i Institutit të Mjekësisë Ligjore. Në aktin e ekspertimit toksikologjik, eksperti ka konkluduar se “*Nga shqyrtimi i rastit konstatohet se monstra e gjakut të shtetasit Floren Myrtaj është sjellë me vonesë, jashtë intervalit 48 orësh nga momenti i marrjes. Lidhur me procedurat e marrjes së mostrave biologjike, ambalazhimit, ruajtjes, transportimit, afatit dhe intervalit kohor dhe dokumentacionit të nevojshëm në kemi dërguar pranë të gjitha institucioneve që iu shërbejnë (Drejtore të Policive në Qarqe, Komisariateve të Policisë, Prokurorive dhe Gjykatave), një procedurë standarte të punës në Laborator në lidhje me ekspertimet toksikologjike. Mostra biologjike të cilat dërgohen në laboratorin e Toksikologjisë jashtë intervalit kohor prej 48 orësh, nuk merret në konsideratë për tu analizuar sepse:*

1. Mostra biologjike duhet të mbahet në kushte frigoriferike në temperaturë +4 gradë celsius deri në 48 orë dhe menjëherë të dërgohen në Laborator për të filluar proceset e analizës toksikologjike.

2. Mbajtja e mostrave biologjike nën ndikimin e temperaturave të larta, të dritës, etj, bën që këto mostra si rezultat i metaboliteve të jenë të pabesueshëm në rezultatin e marrë.

3. Nisur nga fakti që mostra biologjike e shtetasit Floren Myrtaj nuk është dorëzuar në laborator sipas procedurave standarte të punës dhe dorëzimit korrekt, nuk mund të analizohet pasi cilido qoftë rezultati i marrë (pozitiv apo negativ), nuk mund të merret në konsideratë për interpretim. Rezultati i marrë është i pabesueshëm në rastin konkret nga pikpamja toksikologjike – ligjore”.

2.4 Në rrethanat e mësipërme, Prokurori i çështjes, Andi Pogaçe, ka aritur në konkluzionin se gjatë hetimit të proçedimit penal, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Koç Gega janë kryer disa shkelje flagrante ligjore dhe proçedurjale. Oficeri i Policisë Gjyqësore Koçi Gega ka vepruar në kundërshtim me procedurat standarte të punës që IML i ka dërguar Drejtorisë Vendore të Policisë Fier me shkresën nr.1340 prot., datë 03.09.2015, ku përcaktohet se mostra biologjike duhet të depozitohet pranë IML Tiranë, brenda 48 orëve. Në rastin konkret mostra biologjike nga oficeri Koçi Gega është dërguar tej afatit 48 orë.

Si pasojë e kësaj shkelje me pasoja të rënda, nuk është bërë e mundur evidentimi i faktit nëse i dyshuari ka qenë duke drejtuar mjetin në gjendje të dehur apo nën efektin e lëndëve narkotike.

Këto veprime dhe shkelje të kërkesave ligjore dhe proçedurjale, të kryera nga oficeri i Policisë Gjyqësore Koçi Gega, nga ana e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe, konsiderohen si shkelje disiplinore të parashikuara nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, neni 33, pika 4, gërma “ç”, ndaj kërkon dhënien ndaj tij të një nga masave disiplinore, të parashikuara nga neni 34, pika 4 e ligjit të sipërcituar.

3. Nga tërësia e materialeve të administruara gjatë shqyrtimit të proçedimit disiplinor, analiza e tyre, shjegimet e vetë subjektit të proçedimit disiplinor, u provua se gjatë hetimit të proçedimit penal nr.498, regjistruar në datën 17.05.2022 janë shkelur kërkesat e Kodit të Proçedurës Penale dhe aktet e tjera të dala në zbatim të tij, cilat parashikojnë rregullat për kryerjen e ekspertimit si mjet për kërkimin e provës dhe dispozitat që parashikojnë mënyrën e marrjes, fiksimit, administrimit, dhe trajtimit të provave, përfshirë dhe materialet biologjike. U provua se në rastin konkret është vepruar në kundërshtim me procedurat standarte të punës që Instituti i Mjekësisë Ligjore i dërguar Drejtorisë Vendore të Policisë Fier me shkresën nr.1340 prot., datë 03.09.2015, ku përcaktohet se mostra biologjike duhet të depozitohet pranë IML Tiranë, brenda 48 orëve. Duke u shkelur ky afat, rezulton se, mostra e gjakut për ekspertim, e marrë në kuadër të këtij proçedimi penal, është dorëzuar në Institutin e Mjekësisë Ligjore, tej afatit 48 orë. Instituti i Mjekësisë Ligjore, si institucioni përgjegjës dhe kompetent për kryerjen e ekspertimeve mjekoligjore, për kryerjen e ekspertimeve toksikologjike me mostrat e gjakut, ka përcaktuar si kohë të dorëzimit të mostrave të gjakut në këtë institut afatin 48 orë nga momenti i marrjes së saj nga subjekti që kërkon kryerjen e ekspertimit. Instituti i Mjekësisë Ligjore argumenton se dërgimi i mostrave të gjakut tej këtij afati, dhe jo në kushtet e kërkuara për ruajtje, bën që mostra e gjakut të humbasë cilësitë si rezultat i metabolizmave dhe rezultati i marrë nga analizat të jetë i pabesueshëm.

Referuar sa më sipër Komisioni konstaton se këto veprime dhe mosveprime të oficerit të Policisë Gjyqësore, Koçi Gega janë në shkelje të kërkesave të neneve 30, 293, 294 të Kodit të Proçedurës Penale, të cilat rregullojnë mënyrën e marrjes, fiksimit, administrimit, dhe trajtimit të provave, dhe nenit 178 e vijues të këtij Kodi, për kryerjen e ekspertimeve, duke sjellë pasoja të pariparueshme për hetimin e proçedimit penal.

3.1 Lidhur me këto shkelje, Oficeri i Policisë Gjyqësore, Koçi Gega para Komisionit pranoi ekzistencën e këtyre shkeljeve (dorëzimi i mostrës së gjakut në IML tej afatit 48 orë), por ky veprim nuk është kryer me dashje dhe për faj të tij, por për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe mungesës së organizimit të punës nga ana e drejtueve të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, për sigurimin e mjeteve për marrjen e provave dhe dërgimin e tyre në kohë në institucionet përkatëse. Oficeri i Policisë Gjyqësore Koçi Gega shpjegoi se për dërgimin e mostrave të gjakut për ekspertim në IML oficerët e policisë gjyqësore të Drejtorisë së Policisë Fier, veprojnë privatisht dhe pohon se jo vetëm nuk kanë mjete dhe burime njerëzore për dërgimin e provave për ekspertim, por kanë dhe mungesa për materialet që përdoren për marrjen dhe ruajtjen e mostrave të gjakut. Oficeri i policisë Koçi Gega u shpreh para Komisionit se kjo është gjendja në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier. Sipas shpjegimeve të tij, ka raste që edhe mjetet më elementare, sikurse janë epruvetat për marrjen e mostrave të gjakut, ata i sigurojmë privatisht sepse në spital nuk gjenden. Edhe ruajtjen e mostrave, e bëjnë në frigoriferët në banesat e tyre, sepse në polici nuk ka frigorifer. Për rastin konkret, oficeri i Policisë Gjyqësore Koçi Gega shpjegoi se mostren e gjakut e ka dërguar në IML me kolegun e tij Ilo Ngjela, i cili është me banim në Tiranë dhe se ai gjithmonë ndihmon të gjithë oficerët e policisë gjyqësore të Drejtorisë për dorëzimin e mostrave në IML. Në të kundërt do të duhet të lënë shërbimin dhe të shkojnë në Tiranë për të dorëzuar mostrat, sepse nga Drejtoria nuk u është siguruar asgjë. Oficeri i Policisë Gjyqësore shpjegoi gjithë procedurën që ai ka ndjekur për dërgimin e mostrës së gjakut në IML, duke sqaruar se pasi ka marrë mostrën e gjakut, e mbajtur atë natë në frigoriferin e banesës së tij. Ditën e nesërme, pasi ka përpiluar shkresën, dhe ka prituri deri sa është nënshkruar nga eprorët e tij, rreth orës 13.30 e ka çuar në sekretarin e drejtorisë për ta nisur në IML. Meqëse sekretaria nuk ka marrë përsipër dërgimin në kohë të materialeve në IML, nga ana e tij është gjetur rruga alternative duke e nisur mostrën me kolegun Ilo Ngjela. Meqëse punonjësi i policisë Ilo Ngjela ka mbritur në Tiranë rreth orës 17.30, dhe IML ka qenë mbyllur, ka shkuar dhe e ka dorëzuar mostrën ditën e nesërme.

3.2 Këto pretendime dhe parashtrime të oficerit të policisë gjyqësore Koçi Gega, gjetën mbështetje nga shpjegimet dhe sqarimet që dha para Komisionit, punonjësi i policisë Ilo Ngjela, i thirrur si dëshmitar me kërkesë të subjektit të proceduar Koçi Gega. Ky dëshmitar shpjegoi se shpesh kolegët e punës i kërkojnë të çojnë në IML vendimet e ekspertimit dhe mostrat e gjakut që ata marrin në funksion të hetimit të procedimeve penale. Sipas tij, veprohet në këtë mënyrë sepse në të kundërt oficerëve të policisë gjyqësore do të duhej të linin shërbimin për të sjellë vetë në Tiranë dhe se drejtoria e Policisë Fier nuk ka mjete apo njerëz që të jenë ngarkuar me dorëzimin e mostrave në IML. Dëshmitari shpjegoi se dhe në rastin konkret mostra i është dhënë nga oficeri i policisë gjyqësore Koçi Gega dhe ai e ka dorëzuar në IML ditën tjetër.

3.3 Komisioni i Policisë Gjyqësore, gjatë kësaj periudhe të funksionimit të tij, ka zhvilluar disa procedime disiplinore ndaj disa oficerëve të Policisë Gjyqësore të Sektorit të Qarkullimit Rrugor të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier. Shkelja disiplinore që u është atribuar është e njëjta dhe ka të bëjë me dorëzimin me vonesë, tej afatit 48 orë, në IML, e mostrave të gjakut për ekspertim. Edhe në këto raste, oficerët e Policisë Gjyqësore të proceduar, Fatos Sulo dhe Bujar Arapi, kanë ngritur të njëjtat arsye pse materialet për ekspertim shkojnë me vonesë në IML. Kjo për arsye se nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier nuk janë marrë masa dhe nuk është

organizuar puna për mënyrën e orëzimit të këtyre materialeve. Kjo i ka detyruar oficerët e Policisë Gjyqësore që të mundohen ta zgjidhin problemin privatisht.

4. Nga tërësia e provave të administruara gjatë shqyrtimit të procedimit disiplinor dhe analiza tyre, u provua se gjatë hetimit të procedimit penal nr.498, regjistruar në datën 17.05.2022 janë shkelur kërkesat e Kodit të Proçedurës Penale dhe aktet e tjera të dala në zbatim të tij, cilat parashikojnë rregullat për kryerjen e ekspertimit si mjet për kërkimin e provës dhe dispozitat që parashikojnë mënyrën e marrjes, fiksimit, administrimit, dhe trajtimin e provave, përfshirë dhe materialet biologjike. Në vlerësimin e tyre, nëse shkeljet e kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale lidhur kryerjen e ekspertimit si mjet për kërkimin e provës dhe dispozitat që parashikojnë mënyrën e marrjes, fiksimit, administrimit, dhe trajtimin e provave, përfshirë dhe materialet biologjike. të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Koçi Gega, përbëjnë shkelje disiplinore, Komisioni i referohet parashikimeve që ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” bënë për shkeljet disiplinore, veprimet dhe sjelljet që konsiderohen shkelje disiplinore, natyrën e tyre dhe pasojat që duhet të sjellin. Në këndvështrim të këtyre parashikimeve që ligji i sipërcituar, në nenin 33, u bënë shkeljeve disiplinore të oficerëve të Policisë Gjyqësore, Komisioni vlerëson se, këto veprime të oficerit të Policisë Gjyqësore janë në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të K.Pr.Penale dhe aktet e tjera të dala në zbatim të tij. Por, këto shkelje nuk ngrihen në nivelin e shkeljes disiplinore në formën “kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Proçedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”, e parashikuar nga neni 33, pika 4, gërma “ç”, e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore. Komisioni ka parasysh se jo çdo shkelje e kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale përbën automatikisht dhe shkelje disiplinore dhe për pasojë oficeri i policisë gjyqësore duhet të ndëshkohet me masë disiplinore. Për arsyet që shpjegua më lartë, ato nuk mund të ngrihen në nivelin e shkeljes disiplinore dhe të klasifikohet si shkelje shumë e rëndë, në kuptim të ligjit 25/2019. Shkelja disiplinore që të konsiderohet e tillë, kërkon patjetër pa tjetër qëndrimin subjektiv ndaj shkeljes, të atij që i kryen ato, kërkon që subjekti e di që shkelet ligji dhe vepron me dashje të plotë në kryerjen e shkeljes, çka nuk është vertetuar në rastin konkret.

Komisioni vlerëson se në rastin konkret, shkeljet e kërkesave të K.Pr.Penale nuk janë kryer me dashje dhe nuk janë të qëllimshme. Ato kanë ardhur si pasojë mosorganizimit të punës dhe mosmarrjes së masave të nevojshme nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier për garantimin e mjeteve të nevojshme për dorëzimin në kohë dhe në mënyrë të rregullt të vendimeve të ekspertimit dhe provave dhe mostrave që dërohen për ekspertim, në institucionet që ngarkohen me kryerjen e ekspertimit.

5. Në përfundim, në analizë dhe vlerësim të akteve të administruar gjatë shqyrtimit të procesit disiplinor, përfshirë dhe sqarimet dhe shpjegimet e subjektit të procedimit disiplinor, Komisioni i Policisë Gjyqësore, arrin në përfundimin se shkeljet disiplinore të parashtruara si të kryera nga oficeri i Policisë Gjyqësore Koçi Gega, nuk qëndrojnë.

Në rastet kur shkeljet disiplinore nuk provohen ose nuk qëndrojnë, referuar nenit 38 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” dhe nenit 13 të Rregullores

nr.10, datë 21.04.2020 “Për procedimin disiplinor”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, Komisioni duhet të pushojë procedimin disiplinor.

Për sa më sipër, në bazë të neneve 10, shkronja “ç”, 11, pika 4 dhe neni 38 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Komisioni i Policisë Gjyqësore me 4 vota pro.

V E N D O S I:

1. Pushimin e procedimit disiplinor ndaj Oficerit të Policisë Gjyqësore Koçi Gega, me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier
2. Me këtë vendim , të njihet oficeri i policisë gjyqësore Koçi Gega.
3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI



ANËTAR

ARJAN MUÇAJ

ANËTAR

HARI GOGO

Mungon

ANËTAR

REDI VASILI

ANËTAR

ALBERT MUÇO